VENDIM
Nr. 121, datë 9.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 4, pika 46 dhe të nenit 126, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me përmbajtje si më poshtë:

"Neni 5/1
Përjashtimet

1. Kërkesat e kësaj rregulloreje, përveç sa parashikohet në këtë nen, nuk do të zbatohen për subjektet apo personat që ofrojnë shërbimet e pagesave nëpërmjet telefonisë celulare ose pajisjeve të tjera elektronike, vetëm për blerjen e biletave elektronike (përfshirë transportin, lojërat, parkimin ose hyrjen në evente, por duke përjashtuar produktet fizike), vetëm në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) vlera e një transaksioni pagese nuk tejkalon shumën prej 1,000 (një mijë) lekësh;

b) vlera në total e transaksioneve, për çdo klient, nuk tejkalon shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në muaj; si dhe

c) vlera e parapaguar në total për transaksionet e çdo klienti, në rastin e llogarive me parapagim, nuk tejkalon shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në muaj.

2. Subjektet apo personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, njoftojnë Bankën e Shqipërisë:

a) për veprimtarinë dhe llojet e transaksioneve që kryejnë, duke paraqitur, së bashku me njoftimin, edhe ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit; si dhe

b) në çdo rast kur tejkalojnë kufijtë e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Subjektet apo personat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, paraqesin çdo informacion dhe dokumentacion shtesë që kërkohet nga Banka e Shqipërisë.

4. Banka e Shqipërisë mund të kryejë verifikimin në vend në këto subjekte apo persona, mbi plotësimin e kërkesave të këtij neni."

b) Përmbajtja e pikës 4, të nenit 6, ndryshon si më poshtë vijon:

"Kapitali fillestar minimal i kërkuar për institucionet e parasë elektronike është 50 (pesëdhjetë) milionë lekë."

c) Pas pikës 2, të nenit 32, shtohet pika 3 me përmbajtje si vijon:

"Institucionet e parasë elektronike të licencuara nga Banka e Shqipërisë, marrin masa për plotësimin e kapitalit fillestar minimal të përcaktuar në pikën 4, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, brenda datës 31 dhjetor 2017".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko